

## Vendim nr. 69 datë 05.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Marjana Semini, Anëtare

Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 05.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17(B) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** BARDHYL IBRA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3080, datë 13.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda afatit të arsyeshëm të ankimit kundër vendimit nr. (11-2018-6514)1993, datë 18.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës) dhe përsheptimi i shqyrtimit të tij nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, pikat 1 dhe 2 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Bardhyl Ibra në datën 13.07.2017 ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ndaj punonjësve të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Durrës. Me vendimin e datës 28.12.2017, prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2018-1121) 072, datë 09.03.2018, ka vendosur shfuqizimin e vendimit dhe detyrimin e prokurorit për vazhdimin e veprimeve procedurale hetimore.

2. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar prokurorit me kërkesë për sigurimin e provës dhe me pretendimin se kjo kërkesë deri në datën 30.07.2018 nuk ishte shqyrtuar, i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesë për konstatimin e shkeljes dhe përshejtimin e gjykimit të saj, bazuar në nenet 399/1 e vijues të Kodi i Procedurës Civile (*KPC*). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 120, datë 30.07.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe detyrimin e prokurorit për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e provës dhe daljen me vendim të arsyetuar.

3. Më pas, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me padi kundër Ministrisë së Drejtësisë (*MD*) dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (*MFE*) me objekt shpërblimin e dëmit në vlerën 100 000 lekë për mosmarrjen në shqyrtim nga prokuroria të kërkesës për sigurim prove. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2018-6514) 1993, datë 18.12.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se nenet 399/1 e vijues të KPC-së nuk gjejnë zbatim për afatet e shqyrtimit të kërkesave për sigurimin e provës dhe se vendimi nr. 120, datë 30.07.2018, i paraqitur si provë nga kërkuesi, nuk ka konstatuar shkeljen e afatit të arsyeshëm të hetimit paraprak të veprës penale të kallëzuar. Në datën 15.01.2019 kërkuesi ka paraqitur apel ndaj këtij vendimi dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit Durrës në datën 04.02.2019 me numër 1303/21234-0205-10-2019.

4. Në datën 29.05.2023, bazuar në nenet 399 e vijues të KPC-së, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyqimit të ankimit të tij nga Gjykata e Apelit Durrës brenda afatit të arsyeshëm. Në përmbajtje të asaj kërkesë ai ka parashtruar se gjykata e apelit po zvarrit gjykimin e çështjes së tij ndaj vendimit gjyqësor të datës 31.01.2018, me të cilin gjykata e shkallës së parë i kishte kthyer aktet në një çështje tjetër gjyqësore.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3080, datë 13.07.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se kërkuesi ka parashtruar pretendime ndaj një

vendimi gjyqësor të datës 31.01.2018 për kthimin e akteve, për të cilin nga verifikimet rezulton se ai nuk ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit. Po ashtu, sipas Gjykatës së Lartë, në Gjykatën e Apelit gjendej një çështje e regjistruar e kërkuarit, e cila lidhej me ankimin ndaj vendimit të datës 18.12.2018 për rrëzimin e padisë për shpërblimin e dëmit nga veprimet e prokurorisë për sigurimin e provës. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje të fundit nuk mund të pranohej për shkak të pamundësisë objektive të sistemit gjyqësor, që karakterizohet nga një volum i lartë çështjesh gjyqësore dhe numër i ulët gjyqtarësh.

6. Në datën 30.11.2023 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar konstatimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm të procesit gjyqësor që kishte përfunduar me vendimin e kthimit të akteve, si dhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që lidhej me procesin gjyqësor në pritje për t'u shqyrtuar në gjykatën e apelit. Në këto rrethana të paqarta, Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 05.02.2024, vendosi kthimin e kërkesës për saktësimin e objektit në drejtim të procesit gjyqësor ndaj të cilit ngriheshin pretendimet për tejkalimin e afatit të arsyeshëm, si dhe plotësimin e dokumentacionit lidhur me procesin gjyqësor. Në zbatim të këtij vendimi kërkuari paraqiti dokumentacionin në Gjykatë në datën 25.03.2024, duke saktësuar se pretendimet e tij lidheshin me vendimin nr. (11-2018-6514) 1993, datë 18.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për rrëzimin e padisë për shpërblim dëmi gjatë procedurave të shqyrtimit të kërkesës për sigurim prove.

## II

### **Pretendimet e kërkuarit**

7. *Kërkuari* ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Apelit Durrës nuk ka shqyrtuar ende ankimin e tij të paraqitur në datën 15.01.2019 kundër vendimit gjyqësor nr. (11-2018-6514) 1993, datë 18.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

## III

### **Vlerësimi i Kolegjit**

#### *A. Për legjitimitetin e kërkuarit*

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji rithekson se e drejta për proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimimi brenda një afati të arsyeshëm, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe se kjo e drejtë luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (*shih vendimet nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në përmbajtjen e saj, kjo dispozitë kushtetuese parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor (pika 1) dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj (pika 2).

10. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi pretendon gjykimin përtej afatit të arsyeshëm të çështjes së tij në gjykatën e apelit, që ende nuk ka përfunduar, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e tij për përshpejtimin e procedurave. Në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është ecuria e gjykimit të kërkesës së tij për shpërblim dëmi nga mosshqyrtimi prej prokurorisë i kërkesës për sigurim prove gjatë një procedimi penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, të vënë në lëvizje me kallëzim të kërkuesit. Ky gjykim ka përfunduar në shkallën e parë me rrëzimin e padisë, me arsyetimin se nenet 399/1 e vijues të KPC-së nuk rregullojnë afatet e shqyrtimit të kërkesës për sigurim prove, ndaj nuk mund të jepet shpërblim për vonesat e tyre, ndërsa kërkuesi ka paraqitur apel dhe çështja është në pritje për t’u shqyrtuar nga gjykata e apelit.

11. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se neni 42 i Kushtetutës nuk merr në mbrojtje procesin gjyqësor për të cilin kërkuesi ka ngritur pretendimin për afatin e arsyeshëm, pasi në themel të tij qëndron kërkesa për sigurim prove. Kjo e fundit, edhe pse ka vënë në lëvizje një

proces gjyqësor të veçantë, përbën në vetvete një prej veprimeve të procedimit penal. Dispozita kushtetuese ofron mbrojtje për afatin e arsyeshëm të procedimit penal në tërësinë e tij, qoftë ai në fazën e hetimit paraprak, të gjyqimit ose të ekzekutimit. Në këto rrethana, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë interesin kushtetues për vënien në lëvizje të Gjykatës, ndaj çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

12. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.